



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY  
Adresa Rr. Zija Shemsiu pn, 60000 Gjilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net

Rektori: Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Vendim.nr. 011242/08/02/2021

Në bazë të nenit 48, pika 1.3 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 05.02.2021, mori:

### VENDIM

Dr.sc. Arben Sahiti, zgjedhet në thirrjen akademike **Profesor Asistent** për lëndët: Kontabilitet, Kontabilitet publik, Menaxhim financiar i ndërmarrjeve, Menaxhment bankar dhe lëndë të tjera nga fusha e Banka, Financa dhe Kontabilitet në Fakultetin Ekonomik në Universitetin "Kadri Zeka" Gjilan.

Emërimi është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 153 dhe 157 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statuti të Universitetit.

Emërimi zgjatë 4/katër/vite.

Të përmendurit i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhurat personale.

Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me dispozitat pozitive.

### Arsyetim

Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan ka shpallur konkurs për zgjedhjen/rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: Kontabilitet, Kontabilitet publik, Menaxhim financiar i ndërmarrjeve, Menaxhment bankar dhe lëndë të tjera nga fusha e Banka, Financa dhe Kontabilitet në Fakultetin Ekonomik në Universitetin "Kadri Zeka" Gjilan. Komisioni recensues dhe Komisioni i studimeve i ka propozuar Senatit të Universitetit që Ass.Dr. Arben Sahiti, i plotëson kushtet për t'u zgjedh në thirrjen akademike Profesor i Asistent për lëndët e sipërpërmendura. Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, duke i marrë për bazë vlerësimin e Komisionit Recensues dhe propozimin e Komisionit të Studimeve, vendosi që Dr.sc. Arben Sahiti, të zgjedhet në thirrjen akademike Profesor i Asistent.


Në bazë të kësaj që u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në web faqe, Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa të Senatit të Universitetit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Të përmendurit
2. Zyrës së personelit
3. Arkivit të Universitetit
4. Zyrës së financave



  
Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi, rektor  
Kryesues i Senatit